



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064416

Datë: 23.05.2019

Numri i dokumentit: 00326357

P. nr.836/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. Sh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1-1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1577/18 të datës 23.11.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **13.05.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi, të dëmtuarës Sh. I. dhe të akuzuarit Sh. Sh., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa përpiluar me dt.17.05.2019, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **SH. SH. nga Gjakova, Rr” . . . “ p.n**, i biri Xh. dhe i nënës R. e gjinisë A., data e lindjes . . . , në Gjakovë, ka të kryer 3 kl. të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike - shfrytëzues i ndihmave sociale, egjiptian, shtetas i R. Kosovës, në bashkësi jashtëmartesorë, ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- sot me **dt.19.10.2018, rreth orës 20.50 min**, në shtëpinë e tyre të përbashkët në Gjakovë „Rr.” . . .”, i shkakton lëndime të lehta personit tjetër të dëmtuarës-bashkëshortes së tij Sh. I., në atë mënyrë që për shkak të problemeve të vazhdueshme që kishin në mes vete, e dëmtuara ishte larguar nga shtëpia, i pandehuri ditën kritike e fton në shtëpi të dëmtuarën për ta dërguar të mjeku pasi që e njëjta ishte shtatzënë dhe aty për një moment nën ndikim të alkoolit, e sulmon fizikisht duke e goditur me një kablo të rrymës në pjesët të ndryshme të trupit si në fytyrë, në shpinë dhe në të dyja këmbët, me ç’rast të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore, të konstatuara sipas akt-ekspertimit mjeko –ligjor të Dr. M. G. të dt. 08.11.2018.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3-1-1.4 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 188/3-1-1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-se, të akuzuarit i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2(dy) vite**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës

Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese të dënimit me kusht do ta bënë Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Gjakovë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr., 1577/18 të datës 23.11.2018 ndaj të akuzuarit Sh. Sh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 3-1-1.4 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar me datë 13.05.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi lexon aktakuzën PP.nr.1577/18 dt.23.11.2018, me ç 'rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës por bënë precizimin e kualifikimit juridik të veprës penale ku në vend të nenit 188/3-4.1 duhet të jete 188/ 3-1-1.4 të KPRK-ës me qene se kemi të bëjmë me dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme trupore .

I akuzuari Sh. Sh. , në shqyrtimin fillestar thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer të cilën veprë e kam kryer në afekt dhe në gjendje të dehur , kërkoj falje nga i dëmtuara për lëndimet e shkaktuara , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem më i kujdesshëm, me të dëmtuarën jemi pajtuar dhe jetojmë në bashkësi familjare dhe kemi 2 fëmijë të mitur të përbashkët ,i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm ,gjendjen e dobët ekonomike , si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin ,te me shqiptojë një dënim me të butë .

E dëmtuara Sh. I., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e i akuzuari, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qene se edhe në procedurën paraprake kam deklaruar se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dh nuk kërkon kompensim demi me që me të njëjtin jemi pajtuar dhe nga ajo kohë me nuk kemi pasur probleme mes veti .

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori I shtetit Nazmi Krasniqi deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë dhe pa presion i njëjti i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë ,po ashtu pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në prova dhe fakte që i bashkëngjiten aktakuzës, andaj i propozoi gjykatës që i njëjti të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari Sh. Sh.: se me **dt.19.10.2018, rreth orës 20.50 min,** në shtëpinë e tyre te përbashkët ne Gjakovë „Rr.” . . .”, i shkakton lëndime të lehta personit tjetër te dëmtuarës –bashkëshortes se tij Sh. I., në atë mënyrë qe për shkak te problemeve te vazhdueshme qe kishin ne mes vete , e dëmtuara ishte larguar nga shtëpia , i pandehuri ditën kritike e fton ne shtëpi te dëmtuarën për ta dërguar te mjeku pasi qe e njëjta ishte shtatzënë , dhe aty për një moment nen ndikim te alkoolit , e sulmon fizikisht duke e goditur me një kablo te rrymës ne pjesët të ndryshme ë trupit si në fytyre, në shpinë dhe në të dyja këmbët, me ç ‘rast të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore, të konstatuara sipas akt-ekspertimit mjeko - ligjor të Dr. M. G. te dt. 08.11.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, baba i dy fëmijëve , gjendjen e tij te dobët ekonomike-shfrytëzues i ndihmave sociale ,pranimin e fajësisë , sjelljen korrekte në gjykim , kërkim falja nga e dëmtuara për lëndimin që i është shkaktuar në afekt, premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, deklarimi i te dëmtuarës se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **1 (një)viti** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) vite** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale , ku në rast të revokimit të dënimit me kusht të njëjtit duhet ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 23.10.2018 gjerë me datën 22.11.2018, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimi i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën pasurore juridike nga se e dëmtuara Sh. I. , gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë paraqit kërkesë pasurore juridike.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-ës ,pasi qe i akuzuari është shfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.836/18 më datë 13.05.2019.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.